



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJES

I.Numër: 463-01/11415, dt: 28 Shkurt 2025

Në bazë të nenit 11 dhe 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të datës 20 shkurt 2008 dhe në mbështetje të nenit 24 dhe 25 të Ligjit nr.06/L-092 mbi Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës Komunale, nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës I.Numër: 01-016/01-413431 dt.30 shtator 2020, pasi shqyrtoi propozimin e Kryetarit të Komunës për Miratimin e Këmbimit të Pronës së paluajtshme Komunale me pronën e pronarëve privat Fisnik (Rexhep) Elshani dhe Edona (Rexhep) Elshani, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur më datë: 28 Shkurt 2025, mori këtë:

VENDIM

Nr. 06/2025

Mbi Miratimin për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të Fisnik (Rexhep) Elshani dhe Edona (Rexhep) Elshani me qëllim të rregullimit të shtratit të Lumit “Lumbardh” dhe hapjen e shetitores si Interes Publik sipas Planit Zhvillimor Komunal

- I. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private me qëllim të rregullimit të shtratit të Lumit “Lumbardh” dhe hapjen e shetitores si Interes Publik, sipas Planit Zhvillimor Komunal.
- II. Parcelat kadastrale nr.2145-2 me sipërfaqe prej 188m² ZK Pejë, nr.2146-2 me sipërfaqe prej 55m² ZK Pejë dhe nr.2146-4 me sipërfaqe prej 85m² ZK Pejë – me shtëpi pronë e pronarëve privat Fisnik (Rexhep) Elshani dhe Edona (Rexhep) Elshani, do të merren për nevoja të rregullimit të shtratit të lumit “Lumbardh” dhe hapjen e shetitores si Interes Publik sipas Planit Zhvillimor Komunal dhe në të njëjtën kohë do të jetë objekt këmbimi me parcelën kadastrale nr.615-1 me sipërfaqe prej 1410m² ZK Vitomiricë pronë **Komuna e Pejës**.
- III. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë Vlerësimet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Departamenti i Tatimit në Pronë të aprovuara me datën 07.02.2025.
 - Prona e Komunës, ngastra kadastrale nr. 615-1 në sipërfaqe prej 1410m² ZK Vitomiricë është vlerësuar 120.00 €/m², përkatësisht totali i 69,200.00 €.
 - Prona private e Fisnik (Rexhep) Elshanit dhe Edona (Rexhep) Elshanit është vlerësuar me gjithsej 241,840.00 €.Andaj obligohet Komuna e Pejës që të paguaj diferencën në shumën prej 72,640.00 € Fisnik (Rexhep) Elshanit dhe Edona (Rexhep) Elshanit bazuar në Vlerësimin e bërë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Departamenti i Tatimit në Pronë.
- IV. Kjo procedurë e Këmbimit do ti nënshtrohet Vlerësimit të Ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

- V. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Çështje Pronësore-Juridike.
- VI. Ky vendim shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në Web-faqen e Komunës së Pejës.

Vendimi ti dërgohet:
MAPL-së,
Kryetarit të Komunës,
DÇPJ,
Arkiv.

